

*This unofficial translation of Recommendation CM/Rec(2018)1 was performed pro bono by the Macedonian Agency for Audio and Audiovisual Media Services. The Council of Europe encourages the translation and distribution of its legal instruments by interested parties, but does not assume responsibility for the accuracy of the new language version of the text. The English and French versions of this Recommendation as adopted by the Committee of Ministers are the only authentic texts and should be consulted in case of doubt.*

Këshilli i Evropës

Komiteti i ministrave

ZËVENDËSMINISTRAVE

Rekomandimet

CM/Rec(2018)1

7 mars 2018

---

## **Rekomandimi CM/Rec(2018)1<sup>[1]</sup> i Komitetit të ministrave deri te vendet anëtare për pluralizëm në medime dhe transparencë të pronësisë mediatike**

*(Miratuar nga Komiteti i ministrave më datë 7 mars 2018, në takimin e 1390-të të zëvendësministrave)*

---

### **Preambula**

1. Liria dhe pluralizmi i medimeve janë pasoja esenciale nga e drejta e lirisë së të shprehurit, ashtu siç është e garantuar me nenin 10 të Konventës për mbrojtje të drejtave të njeriut dhe lirive fundamentale (Seri nga marrëveshjet evropiane (ETC), nr. 5, “Konventa”). Ato janë kyçe për funksionimin e një shoqërie demokratike sepse ndihmojnë që të sigurohet qasja dhe dispozicioni i informatave vizioneve të ndryshme, në bazë të të cilave individët mund të formojnë dhe të shprehin mendimin e tyre si dhe të shkëmbejnë informata dhe ide. Përveç kësaj, transparenca e pronësisë mediatike mund të ndihmojë pluralizmin politik që të bëhet efektiv, në mënyrë që do të orientojë vetëdijen e opinionit dhe pushtetit rregullator ndaj strukturve pronësore që qëndrojnë prapa medimeve, e që mund të ndikojnë ndaj politikave redaktuese.
2. Komiteti i ministrave të Këshillit të Evropës në shumë tekste/vendime të saja paraprahe ka nënvizuar se sa pluralizmi mediatik dhe transparenca e pronësisë mediatike janë të rëndësishme për debatin publik në shoqëritë demokratike. Korniza ekzistuese duhet të zhvillohet edhe më tutje për shkak të ballafaqimit me ndryshimt vijuese teknologjike, financiare, rregulluese dhe shumë ndryshime tjera në sektorin mediatik në Evropë.
3. Me zgjerimin e informatave, ideve, analizave dhe mendimeve, mediumet luajnë rol të rëndësishëm në çdo shoqëri demokratike, duke vepruar si ruajtës publik dhe duke siguruar forume për debate publike. Mediumet tradicionale vazhdojnë të luajnë këtë rol në eko-sistemin evolutiv multimedial, por rolet e këtyra gjithnjë e më shumë po luhen edhe nga aktorë tjerë mediatik dhe jomediatik – nga korporatat multinacionale e deri te organizatat joqeveritare dhe individët. Të gjithë këto aktorë duhet të jenë përgjegjës para opinionit në mënyrë që është adekuate me rolin që e luajnë ato në raport me cirkulimin e informatave dhe ideve. Ekzistimi i sistemeve efektive vetërregulluese mund ta rrisë edhe përgjegjësinë dhe besimin publik.
4. Llojet e ndryshme të medimeve, së bashku me zhanrret ose format e ndryshme të përmbajtjeve ose programeve redaktuese, kontribuojnë për shumëllojshmërinë e përmbajtjeve. Edhe pse përmbajtjet janë të fokusuar në lajme dhe çështje aktuale kanë rëndësinë me direkte për zhvillimin e shoqërisë

së iformuar, po aq të rëndësishme janë edhe zhanret tjera. Shembujt përfshijë edhe përmbajtje kulturore, edukative dhe me karakter argëtues, si dhe përmbajtjet e orientuara ndaj pjesëve tjera të shoqërisë, siç janë përmbajtjet lokale dhe ato të dedikuara për grupet e rreziluara, si minoritetet dhe personat me pengesa.

5. Në mjedisin e tanishëm multimedial, mediumet onlajn dhe platformat e tjera të internetit mundësojnë qasje deri te një spektër në rritje të informatave nga burime prej më të ndryshmeve. Ky transformim në mënyrën e qasjes dhe shfrytëzimit të përmbajtjeve ndiatike krijon mundësi të reja për interaksion dhe komunikim të ndërsjellë të një numri në rritje të personave dhe për pjesmarrje të tyre në debatin publik.
6. Ky evoluim vijues shkakton edhe brengosje për pluralizmin mediatik. Ndërmjetësuesit e internetit fitojnë gjithnjë e më tepër kontroll ndaj rrjedhës, qasjes, gjindshmërisë dhe qasjes deri te informatat dhe përmbajtjet tjera në Internet. Kjo mund të reflektojë edhe ndaj llojllojshmërisë së burimeve mediatike ndaj të cilëve ekspozohen individët dhe të sjellë deri te selektimi i tyre ose ekspozimi ndaj informatave që i konfirmojnë pasqyrimet dhe mednimet ekzistuese të tyre, që në mënyrë shtesë forcohet me shkëmbimin e mendimeve tjera të njëjtat (ky fenomen ndonjëher quhet edhe "fluskë filtruese" ose "eho hapsirë"). Ekspozimi selektiv i përmbajtjeve mediatik dhe kufizimin pasues të shfrytëzimit të tyre mund të gjenrojë fragmentime dhe të rezultojë me një shoqëri edhe më të polarizuar. Selektimi dhe prezantimi i këtyllë i personalizuar i përmbajtjeve mediatike është brengosës veçanërisht nëse shfrytëzuesit individual nuk janë të vetëdijshëm për këto procese ose nuk i kuptojnë ato.
7. Aktivitetet e ndërmjetësuesve dallohen nga ato medime tradicionale në drejtim të sigurimit të lajmeve. Prapë se prapë, fusha e gjërë e informatave që distribuohen, shtrirja e tyre deri te publiku i gjërë dhe potenciali i tyre për reklamim rreptësisht të targetuar, kanë kontribuar që të hyrat nga reklamimi dhe marketingu të drejtohen kah Interneti. Këto trende i sjellin në pikëpyetje edhe modelet tradicionale të veprimtarisë mediatike dhe kontibojnë për rritjen e konsolidimit dhe konvergencës mediatike. Një ose disa pronarë mediatik ose edhe grupe të tilla, mund të fitojnë pozita të fuqisë së konsiderueshme, prej të cilave pastaj munden që mes vete ose gjithë së bashku të caktojnë agjencën e debatit publik ose me rëndësi të ndikojnë ndaj mendimit publik ose ta ndryshojnë atë, duke riprodhuar të njëjtat përmbajtje nëpër të gjitha platformat ku janë të pranishëm ata. Këto trende gjithashtu mund të sjellin deri te ulja e shpenzimeve, humbjeve të vendeve të punës në gazetarinë tradicionale dhe krijimit të sektorëve mediatik, si dhe rreziq nga varësia financiare e gazetareve dhe medimeve, që në masë të fundit mund të shkaktojë uljen e llojllojshmërisë, besueshmërisë dhe kualitetin e lajmeve dhe përmbajtjeve si dhe të varfërojë debatin publik.
8. Nevojiten vlerësime më të reja të qasjeve ekzistuese të pluralizmit mediatik që të ballafaqohemi me sfidat për lirinë e të shprehurit që del nga mënyra se si shfrytëzuesit, bizneset dhe faktorët tjerë e kanë adaptuar sjelljen e tyre ndaj ndodhive të lartpërmendura. Në lidhje me këtë, me qëllim që të fitohet një pasqyrë gjithëpërfshirëse për ndikimin e ndërmjetësuesve të internetit ndaj pluralizmit në medime, nevojiten më tepër të dhëna krahasuese për atë se si individët i shfrytëzojnë përmbajtjet mediatike në Internet. Përveç kësaj, me rëndësi imperative është që këto ndryshime të reflektojnë në mënyrë adekuate gjatë rregullimit mediatik, me qëllim që të ruhet ose kthehet integriteti i proceseve demokratike dhe të pengohet anshmëria, informatat që krijojnë huti ose humbje të informatave tjera. Nevojiten marrëveshje të reja politike dhe zgjidhje strategjike me qëllim që të ruhet gazetaria e pavarur, kualitative dhe të përmirësohet qasja e qytetarëve deri te përmbajtjet e llojllojshme nga të gjitha tipet dhe formatet mediatike. Gjithashtu, nevojitet që të përgjigjet ndaj brengës gjithnjë e më të madhe për shkak të presionit ndaj medimeve nga ana e interesave politike dhe ekonomike, që veprojnë vetëm ose në bashkëveprim, me qëllim që të ndikojnë në mendimin publik ose në ndonjë mënyrë të godasin pavarësinë e medimeve. Qëllimi i fundit dhe gjithpërfshirës i politikave shtetërore për përkrahjen e pluralizmit mediatik duhet të jetë mbrojtja dhe avancimi i së drejtës për lirinë e të shprehurit.
9. Ekzistimi i shërbimit publik të pavarur dhe të qëndrueshëm dhe medime joprofitabile në shoqëri, mund të shërbejë si kundërpeshë për koncentrimin e rritur mediatik. Për shkak të kompetencës dhe

organizimit të tyre, shërbimet publike mediatike janë të qëlluara veçanërisht për plotësimin e nevojave dhe interesave informative të të gjitha pjesëve në shoqëri, e që e njëjta vlenë edhe për mediumet e bashkësive në aspektin e shfrytëzuesve të tyre. Rëndësi më të madhe kanë autorizimet e shërbimeve publike mediatike që ta përfshijë edhe përgjegjësinë për reflektimin e pluralizmit politik si dhe të nxisin vetëdijen për mendimet e ndryshme, veçanërisht për ofrimin të mundësisë për grupe të ndryshme të shoqërisë - kulturore, gjuhësore, etnike, fetare, seksuale dhe minoritete tjera – që të pranojnë dhe transmetojnë informata, të të shprehin vetveten dhe të shkëmbejnë idetë.

10. Duke marrë parasysh spektrin e rritur të medimeve dhe përmbajtjeve, me rëndësi të madhe për individët është edhe zhvillimi i kapaciteteve dhe aftësive të tyre kognitive, teknike dhe shoqërore, që do të mundësojë qasje efektive të përmbajtjet mediatike dhe të njëjtat ti analizojnë me qasje kritike; të sjellin vendime në mënyrë të informuar për atë se cilat medime duhet t'i shfrytëzojnë; të kuptojnë implikimet etnike të medimeve dhe teknologjive të reja dhe të komunikojnë me efektivitet, përfshirë edhe gjatë krimit të përmbajtjeve. Përveç kësaj, arsimimi mediatik kontribon për pluralizëm dhe llojllojshmëri mediatike, duke ulur nyjen digjitale; përmes lehtësimit të miratimit të vendimeve me informata, veçanërisht në aspekt të çështjeve politike dhe shoqërore si dhe ato komerciale; duke mundësuar identifikimin e informatave të pasakta, të dëmshme dhe jolegale në rrjetet e internetit, si dhe pengimin e tyre.
11. Miratimi i rregullativës për pronësinë mediatike dhe zbatimin e saj efektiv, mund të ketë rol të rëndësishëm në aspekt të pluralizmit mediatik. Legjislatura e këtillë mund ta rrisë transparencën e pronësisë mediatike; mund të zgjidhë çështjet siç janë pronësia ndër-mediatike, pronësia direkte dhe indirekte si dhe kontrolli efektiv i ndikimit ndaj medimeve. Mund të kontribuojë edhe për sigurimin e një ndare efektive dhe të qartë në mes të zbatimit të pushtetit politik ose ndikimit, si dhe kontrollit mbi mediumet ose vendimmarrjen në aspekt të përmbajtjeve mediatike. Transparenca e pronësisë mediatike, organizimi dhe financimi ndihmojnë që të rritet përgjegjësdia e medimeve.
12. Në bazë të kësaj, Rekomandimi e potencon rëndësinë e standardeve ekzistuese të Këshillit të Evropës lidhur me aspektet e ndryshme të pluralizmit mediatik dhe transparencës së pronësisë mediatike, si dhe nevojës që të njëjtat, të zbatohen në shoqëritë demokratike. Rekomandimi i lidh këto standarde, duke adaptuar, plotësuar dhe forcuar të njëjtat, sipas nevojës që të sigurojnë relevancën e tyre të vazhdueshme në ekosistemin aktual multimediatik.
13. Sipas kushteve nga Neni 15.b nga Statuti i Këshillit të Evropës (ETS nr. 1), Komiteti i ministrave të vendeve anëtare jep rekomandimin si vijon:
  - i. të zbatohen në tërësi udhëzimet e dhëna në shtojcën e këtij Rekomandimi;
  - ii. me vëmendje të përcjellin, vlerësojnë dhe të menaxhojnë kërcënimet për lirinë dhe pluralizmin mediatik, përfshirë edhe mungesën e transparencës së pronësisë mediatike, duke kontrolluar rregullisht gjendjet e tregjeve të tyre nacionale mediatike, nga aspekti i pronësisë mediatike, si dhe me miratimin e përgjigjeve dhe masave adekuate rregulluese, përfshirë edhe përkushtimin e një vëmendjeje sistematike të këtyre çështjeve me revizionet rrjedhëse të ligjeve dhe praktikave të tyre nacionale.
  - iii. gjatë implementimit të udhëzimeve, të marrin parasysh praktikën relevante gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut si dhe rekomandimet paraprake të Komitetit të ministrave deri te vendet anëtare, si dhe deklaratat që merren me aspektet e ndryshme të pluralizmit mediatik dhe arsimimit mediatik, veçanërisht rekomandimin [CM/Rec\(2007\)2](#) për pluralizmin në medime dhe shumllojshmërinë e përmbajtjeve mediatike, Deklaratën për
  - iv. mbrojtjen e rolit të medimeve në shoqëri në kontekst të koncentrimin mediatik (31 janar 2007), Rekomandimin [Rec\(99\)1](#) për masat e promovimit të pluralizmit në medime, Rekomandimin [Rec\(94\)13](#) për masat e përmirësimit të transparencës mediatike, si dhe rekomandime tjera relevante dhe deklarata, përfshirë këtu edhe [CM/Rec\(2016\)5](#) Rekomandimin për lirinë e internetit,

- v. Rekomandimin [CM/Rec\(2016\)4](#) për mbrojtjen e gazetarisë dhe sigurisë së gazetarëve dhe aktorëve tjerë mediatik, Rekomandimin [CM/Rec\(2016\)1](#) për mbrojtjen dhe avancimin e së drejtës së shprehjes së lirë dhe jetë private në aspekt të neutralitetit të rrjetit, Rekomandimin [CM/Rec\(2015\)6](#) për arkullim të lirë, ndërkufitar të informatave në Internet, Rekomandimin [CM/Rec\(2012\)3](#) për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në aspekt të kërkuesve, Rekomandimin [CM/Rec\(2012\)1](#) për menaxhimin me shërbimet publike mediatike, Rekomandimin [CM/Rec\(2011\)7](#) për nocione të reja për mediumet, Deklaratën për rolin e mediumeve në shoqëri, për avancimin e kohezionit social dhe dialogut ndërkulturor (11 shkurt 2009),
- vi. Rekomandimin [CM/Rec\(2007\)3](#) për obligimet e shërbimeve publike mediatike në shoqëri informatike dhe Rekomandimin [Rec\(2000\)23](#) për pavarësinë dhe funksionet e trupave rregulluese për sektorin radiodifuziv.
- vii. të promovojnë qëllimet e këtij Rekomandimi në nivel nacional dhe ndërkombëtar dhe të lëshohen në dialog dhe bashkëpunim me të gjitha palët e interesuara me qëllim të arrijtes së këtyre qëllimeve;
- viii. rregullisht të shqyrtojnë masat e ndërmarra për zbatimin e këtij Rekomandimi, me qëllimin e përmirësimit të efikasitetit të tyre.

## Shtesë e Rekomandimit CM/Rec(2018)1

### Udhëzimet për pluralizëm të mediumeve dhe transparencë të pronësisë mediatike

Në kontekst të këtij Rekomandimi, me mediume nënkuptojmë mediumet e shtypit, të emetuara dhe ato online. Në pajtim me Rekomandimin nga [CM/Rec\(2011\)7](#) Komiteti i ministrave deri te vendet anëtare lidhur me nocione të reja për mediumet, nocioni “mediume online” përfshinë një diapazon të gjërë të aktorëve të involvuar në prodhimin dhe përhapjen e përmbajtjeve mediatike në Internet dhe të gjithë ndërmjetësuesve të tjerë ose shërbimeve ndihmëse që me kontrollin e tyre ndaj distribuimit të përmbajtjeve mediatike në Internet ose në vlerësime të ngjashme për përmbajtjet redaktuese që i lidhin ose i transmetojnë, ndikojnë ndaj tregjeve mediatike dhe pluralizmit mediatik. Ky nocion i gjërë i mediumeve kërkon qasje të apsolvuar dhe të diferencuar ndaj zbatimit të standardeve mediatike ndaj aktorëve individual, që duhet t'i nënshtrohen formave dhe niveleve adekuate për mbrojtje dhe përgjegjësi, varësisht nga funksionet e tyre konkrete të procesit mediatik, karakteristikave dhe nevojave të tregjeve evropiane nën jurisdikcion të vendeve anëtare dhe standardeve relevante të Këshillit të Evropës.

#### 1. Rrethi i volitshëm për lirinë e të shprehurit dhe lirinë mediatike

1.1 Parimet e lirisë së të shprehurit dhe lirisë mediatike, të theksuara në Konventën Evropiane për të drejtat e njeriut (ETS nr. 5), vlejné dhe duhet të respektohen edhe në ekosistemin aktual multimediatik, në të cilin u paraqitën një sërë aktorësh të rinj mediatik. Këto parime duhet të zhvillohen më tutje në mënyrë që tërësisht do të ketë parasysh natyrën e zhvillimit të shpejtë të sektorit.

1.2. Vendet anëtare kanë obligime pozitive që të zhvillojnë ambient të volitshëm për lirinë e të shprehurit, brenda dhe jashtë rrjeteve, në të cilat secila mund ta zbatojë të drejtën e saj të lirisë së të shprehurit dhe të merr pjesë në mënyrë efektive në debatin publik, pavarësisht asaj nëse pasqyrimet e tija ose të saja janë mirë të zbatuara nga vendet anëtare ose nga të tjerët. Ambienti i tillë i përfshinë të drejtat e privacisë dhe mbrojtjes së të dhënave, si dhe të drejtës për qasje deri te informatat me interes publik që i kanë trupat publike, që është e nevojshme për realizimin e së drejtës për lirinë e të shprehurit. Shtetet duhet të garantojnë se mediumet jnë të lira dhe pluraliste për shkak të kontributit të tyre të çmueshëm ndaj debatit publik të shëndoshë që mund të formulohet, hulumtohet dhe të ruaj llojllojshmërinë në shoqëri.

1.3. Kornizat nacionale legjislative dhe politike duhet të mbrojnë pavarësinë redaktuese dhe autonominë operative të të gjitha medimeve, që ata të mund të realizojnë detyrat kyçe në një shoqëri demokratike. Këto korniza duhet të përpilohen dhe zbatohen në mënyrë që të pengojë vendet anëtare, ose grupet e ndryshme të fuqishme politike, ekonomike, religjioze, që të dominojnë mbi medimet dhe të bëjnë presion mbi ta.

1.4. Medimet duhet të kenë lirinë dhe resurset që në çdo kohë të mund të plotësojnë detyrën e tyre për të siguruar informim të saktë dhe të besueshëm për çështjet me interes publik, veçanërisht në aspekt të proceseve dhe aktiviteteve vitale demokratike, siç janë zgjedhjet, referendimet dhe konsultimet publike për temat me interes të përgjithshëm. Gjithashtu, duhet të futen mekanizma adekuat mbrojtës, përfshirë edhe masat mbrojtëse ligjvënëse, atje ku është e domosdoshme, që të pengohet përzierja e pavarësisë redaktuese të medimeve, veçanërisht kur bëhet fjalë për informim për konflikte, kriza, korrupsion dhe situata tjera të ndryshme në të cilat gazetaria dhe informimi objektiv dhe kualitativ janë mjetet kryesore në luftën kundër propagandës dhe dezinformatave.

1.5. Në një ambient të volitshëm për lirinë e të shprehurit, autoritetet rregulluese mediatike dhe trupat e tyre të obliguar me rregullimin, përcjelljen e ofruesve tjerë të shërbimeve (mediatike) ose të pluralizmit mediatik, ose për realizimin e ndonjë prej funksioneve tjera të theksuara në këtë Rekomandim, duhet të kenë mundësi për zbatimin e obligimeve të tyre në mënyrë efikase, transparente dhe me përgjegjësi. Parakusht për të bërë këtë është që të kenë pavarësi të garantuar me ligj dhe të zbatuar edhe në praktikë.

1.6. Pavarësia e pushteteve dhe trupave të përmendur në paragrafin paraprak duhet të garantohet përmes sigurimit të transparencës së procedurave të tyre për emërim dhe shkarkim; resurse adekuate nejrëzore dhe financiare si dhe renditje autonome e buxhetit të tyre; funksionimin e tyre sipas procedurave transparente dhe procedurave të vendimmarrjes; niveleve të transparencës për komunikim me opinionin dhe fuqi që vetë të sjellin vendime efikase dhe autonome, në proporcion që ato të mund t'i nënshtrohen ankimit.

1.7. Vendet anëtare duhet të sigurojnë transparencë të pronësisë mediatike, organizimit dhe financimit dhe të avancojnë arsimimin mediatik për t'u dhënë informatë individëve dhe për të krijuar vetëdije kritike për qasje ndaj informatave të ndryshme dhe pjesmarrje të plotë në ekosistemin multimediatik.

## 2. Pluralizmi mediatik dhe llojllojshmëria e përmbajtjeve mediatike

### *Kushtet e përgjithshme të pluralizmit*

2.1. Si garanci përfundimtare të pluralizmit, vendet anëtare kanë obligim pozitiv që të inkorporojnë kornizë adekuate ligjvënëse dhe politike për këtë qëllim. Kjo nënkupton miratimin e masave adekuate për të siguruar llojllojshmëri të mjaftueshme në diapazonin e plotë të llojeve të ndryshme të medimeve, duke marrë parasysh dallimet në këtë drejtim për qëllimet e tyre, funksionet dhe shtrirjen gjeografike. Natyra komplementare e llojeve të ndryshme të medimeve e forcon pluralizmin e jashtëm dhe mund të kontribuojë për krijimin dhe ruajtjen e llojllojshmërisë së përmbajtjeve mediatike.

2.2. Vendet anëtare obligohen që të sigurojnë përcjellje të rregullt dhe të pavarur si dhe vlerësim të gjendjes me pluralizmin mediatik nën kompetencë të tyre, në bazë të përmbledhjes së kriterëve objektive dhe transparente, me qëllim që të identifikohen rreziqet për llojllojshmërinë e pronësisë së burimeve mediatike dhe vetë medimeve; llojllojshmërisë së llojeve të medimeve; llojllojshmërisë së pasqyrimeve të përfaqësuar nga grupe të ndryshme politike, ideologjike, kulturore dhe sociale, si dhe llojllojshmërisë së interesave dhe pasqyrimeve që janë me rëndësi për bashkësitë lokale dhe rajonale. Vendet anëtare duhet gjithashtu që trupave që zbatojnë mbikëqyrjen e pavarur dhe bëjnë vlerësime, t'u sigurojnë qasje të mjaftueshme deri te të gjitha informatat e rëndësishme dhe resurse të mjaftueshme për realizimin e

këtyre detyrave. Më tutje, vendet anëtare nxiten që të zhvillojnë dhe zbatojnë përgjigje rregulluese dhe politike me qëllim të ballafaqimit efektiv me rreziqet e zbuluara.

### *Kushtet e veçanta të pluralizmit*

#### *Llojlojshmëria e përmbajtjeve*

2.3. Shtetet inkurajohen që të miratojnë masat rregulluese edhe politike me qëllim të avancimit të dispozicionit, gjendjes dhe qasjes deri te përmbajtjet e llojlojshme mediatike si dhe përfaqësimit të tërë diversitetit të shoqërisë në medime, përfshirë edhe përkrahjen e iniciativave për ato qëllime nga ana e medimeve. Në drejtim të medimeve audivizuele, këto masa mund të përfshijë edhe rregulla për transmetim të detyrueshëm (must-carry), rregulla për theksim të detyrueshëm të përmbajtjeve me interes të përgjithshëm të udhëzuesve elektronik për programin e TV, si dhe rregullave për qasjen e personave me pengesa.

2.4. Me që ndërmjetësuesit e internetit jo vetëm që i distribuojnë përmbajtjet mediatike, por gjithnjë e më shumë i menaxhojnë, redaktojnë, selektojnë dhe organizojnë ato, vendet anëtare duhet ta njohin llojlojshmërinë e roleve të tyre në prodhimin dhe përhapjen e përmbajtjeve, si dhe shkallët e ndryshme të ndikimit të tyre ndaj pluralizmit në medime. Rregullat eventuale me të cilat rregullohen këto aktivitete duhet të jenë adekuate dhe proporcionale, në tërësi të harmonizuara me kërkesat nga Neni 10 i Konventës si dhe në pajtim me të hyrat progresive dhe të diferencuara sipas Rekomandimit [CM/Rec\(2011\)7](#). Mekanizmat eventuale dhe vetërregulluese, të vendosura në këtë sferë duhet të funksionojnë në mënyrë të pavarur dhe transparente, të jenë të hapura për pjesmarrje të konsiderueshme nga ana e të gjithë faktorëve të rëndësishëm, të jenë transparent para opinionit dhe të punojnë në pajtim me standardet etike që e kanë parasysh tërë ekosistemin multimediatik.

2.5. Vendet anëtare duhet ta inkurajojnë zhvillimin e iniciativave të hapura, të pavarura, transparente dhe pjesmarrëse nga ana e medimeve sociale, aktorëve mediatik, shoqërinë civile, rrethet akademike dhe faktorët tjerë që insistojnë të përmirësojnë ekspozimin efektiv të shfrytëzuesve sipas llojlojshmërisë më të madhe të mundshme sipas përmbajtjeve në internet. Dukshmëria, gjindshmëria, qasja dhe promovimi i përmbajtjeve mediatike në Internet janë më tepër nën ndikimin e procesve të automatizuara, qoftë edhe nëse këto të dytat të përdoren pavarësisht ose në kombinim me vendimet e miratuara nga njeriu. Vendet anëtare duhet të inkurajojnë mediumet sociale, mediumet, mjetet për kërkim dhe rekomandim, si dhe ndërmjetësuesit e tjerë që shfrytëzojnë algoritme, së bashku me aktorët mediatik, trupat rregulluese, shoqëria civile, bashkësia akademike dhe faktorë tjerë relevant, të kyojnë në iniciativat e hapura, të pavarura, transparente dhe pjesmarrëse, të cilat:

- e përmirësojnë transparencën e proceseve të distribucionit online të përmbajtjeve mediatike, përfshirë edhe proceset e automatizuara;
- e vlerësojnë ndikimin e këtyre proceseve ndaj ekspozimit efektiv të shfrytëzuesve të përmbajtjeve të llojlojshme mediatike;
- insistojnë që të përmirësojnë këto procese distributive me qëllim të rritjes së ekspozimit efektiv të shfrytëzuesve të llojlojshme të përmbajtjeve mediatike;
- shfrytëzuesve ju jep informata të qarta për atë se si të gjejnë, të qasen deri te fusha e gjërë e përmbajtjeve që janë në dispozicion, dhe të nxjerrin dobi maksimale nga këto;
- e zbatojnë parimin e definuar të privacisë në drejtim të gjitha teknikave të automatizuara të përpunimit të të dhënave dhe sigurojnë harmonizimin e tyre të plotë me ligjet dhe standardet adekuate për privaci dhe mbrojtjen e të dhënave.

2.6. Vendet anëtare duhet të përqipen, të shfrytëzojnë zhvillimin teknologjik, të sigurojnë qasje deri te përmbajtjet e llojllojshme mediatike, përfshirë edhe përmbajtjet me interes të përgjithshëm, për të gjitha grupet në shoqëri, veçanërisht ato që ndoshta kanë nevoja specifike ose janë në pozitë të pavolitshme ose që ballafaqohen me pengesat kur qasen deri te përmbajtjet mediatike, siç janë grupet e minoriteteve, refugjatët, fëmijët, personat e moshaur ose personat me pengesë kognitive ose fizike. Kjo nënkupton se përmbajtjet e këtilla mediatike duhet të jenë më të qasshme në gjuhë të ndryshme dhe në formate adekuate dhe se duhet të jenë të lehta për t'u gjetur dhe shfrytëzuar.

2.7. Llojllojshmëria e përmbajtjeve mediatike mundet të përcaktohet vetëm atëher kur ekziston nivel më i lartë i transparencës për përmbajtjet redaktuese dhe komerciale: mediumet dhe aktorët tjerë duhet t'u përmbahen standardeve më të larta të transparencës në drejtim të burimit të përmbajtjeve të tyre dhe gjithmonë qartë të theksojnë se kur përmbajtja është marrë nga burime politike ose që përfshinë reklamim ose forma tjera të komunikimit komercial, siç është sponsorimi ose plasimi i prodhimeve. E njëjta vlen edhe për format hibride të përmbajtjes, përfshirë edhe përmbajtjet e brenduara, reklamimin nativ, advertorialët dhe info-argëtimin. Në rastet kur këto obligime nuk janë të plotësuara, duhet të parashihet dispozitë për zbatimin e masave proporcionale nga ana e trupave kompetente rregulluese.

### Korniza institucionale për pluralizëm në medime

#### *Korniza institucionale për pluralizëm në medime*

2.8. Vendet anëtare duhet ta njohin rolin kyç të organizatave të shërbimeve të pavarura publike mediatike gjatë avancimit të debatit publik, pluralizmit politik dhe vetëdijes për mendimet e ndryshme. Për këtë arsye, vendet anëtare duhet të garantojnë kushte adekuate për shërbimet publike mediatike që të vazhdojnë të luajnë këtë rol në peisazhin multimediatik, si dhe të sigurojnë përkrahje adekuate për inovacione dhe zhvillim të strategjive digjitale dhe shërbimeve të reja.

2.9. Vendet anëtare duhet të miratojnë masa të veçanta për mbrojtjen e pavarësisë redaksisë dhe autonomisë operative të shërbimeve mediatike përmes kufizimit të ndikimit të shtetit. Bordet mbikëqyrëse dhe udhëheqëse të shërbimeve publike mediatike duhen të jenë në gjendje që të funksionojnë krejtësisht të pavarur, kurse rregullat që i redaktojnë procedurat për përpilimin e tyre dhe emërimin duhet të jenë transparente dhe të përmbajnë mekanizma adekuate për kontroll të ndërsjellë dhe të sigurohet pavarësia e tyre.

2.10. Vendet anëtare, gjithashtu duhet të sigurojnë financim stabil, të qëndrueshëm, transparent dhe adekuat të shërbimeve publike mediatike për më shumë vite, me qëllim që të garantojnë pavarësinë e tyre nga presionet qeveritare, politike dhe tregtare si dhe të aftësojnë ato për të ofruar spektër të gjërë të informatave pluralistike dhe informata të llojllojshme. Kjo mund të ndihmojë edhe për eliminimin e rreziqeve të shkaktuara nga ndonjë gjendje të caktuar të koncentrimit mediatik. Përveç kësaj, vendet anëtare nxiten, në pajtim me obligimin e tyre pozitiv që të garantojnë pluralizmin mediatik, të ballafaqohen me të gjitha situatat e financimit jo të mjaftueshëm sistematik të medimeve publike, që e çënon pluralizmin e këtillë.

2.11. Vendet anëtare duhet të inkurajojnë dhe përkrahin formimin dhe funksionimin e bashkësive minoritare, rajonale, lokale dhe joprofitabile të bashkësive, përfshirë edhe sigurimin e mekanizmave financiar me qëllim të nxitjes së zhvillimit të tyre. Mediumet e këtilla të pavarura, ju japin zë bashkësive dhe individëve për tema me rëndësi për nevojat dhe interesat e tyre, dhe në këtë mënyrë ndihmojnë krijimin e ekspozimit publik të temave që ndoshta nuk janë të përfaqësuara në mediumet kryesore, si dhe në lehtësimin e proceseve inkluzive dhe pjesëmarrëse në dialogun në dhe ndërmjet bashkësive në nivel rajonal dhe lokal.

2.12. Mediumet që i shërbejnë bashkësive jashtë vendit ku janë krijuara mund të plotësojnë mediumet nacionale dhe të ndihmojnë për grupe të caktuara të shoqërisë, siç janë imigrantët, refugjatët dhe bashkësitë e diasporës, të ruajnë lidhjen me vendet, kulturën dhe gjuhën e tyre amëtare. Vendet anëtare duhet të pengojnë qasjen deri te mediumet e këtilla tejkuftare, nëse publikimi, transmetimi dhe

ritransmetimi; ose cila do formë tjetër e përhapjes së medimeve të këtu në territorin që është në kompetencë të tyre e që janë në pajtim me të drejtën ndërkombëtare.

### *Masat për përkrahjen e medimeve dhe pluralizmit mediatic*

2.13. Me qëllim të rritjes së pluralizmit mediatic, vendet anëtare duhet, në konsultim me përfaqësuesit e medimeve dhe organizatave të shoqërisë civile, të zhvillojnë strategjitë dhe mekanizmat për përkrahje të medimeve profesionale të gazetarisë dhe hulumtimit kualitativ dhe të pavarur, përfshirë edhe produksionin e lajmeve, të aftë për t'u përgjigjur ndaj nevojave dhe interesave të ndryshme të grupeve që mund të mos jenë mjaftë prezente në medime. Ata duhet të shqyrtojnë një spektër të gjërë të masave që duhet të jenë në dispozicion të llojeve dhe platformave të ndryshme mediatike, përfshirë edhe mediumet online. Krahas përkrahjes jofinanciare, vendet anëtare inkurajohen që të sigurojnë edhe forma të ndryshme të ndihmës financiare, siç janë reklamimi dhe subvencionet. Vendet anëtare nxiten edhe për të përkrahur projekte në lidhje me edukimin e gazetarisë, hulumtimit mediatic, gazetarisë hulumtuese dhe qasjeve inovative me qëllim që të forcohet pluralizmi në medime dhe liria e të shprehurit.

2.14. Masat për përkrahje duhet të kenë një qëllim të definuar qartë dhe duhet të bazohen në kritere të përcaktuara paraprakisht, precize, të drejta, objektive dhe transparente. Ato duhet të zbatohen me vlefshmëri të plotë të autonomisë redaktuese dhe operative të medimeve. Këto masa për përkrahje mund të përfshijnë masa pozitive për rritjen e kuantitetit dhe kualitetit të mbulimit mediatic të çështjeve me interes dhe rëndësi për grupet që nuk janë mjaft të përfaqësuara në medime.

2.15. Masat për përkrahje duhet të zbatohen në mënyrë jodiskriminuese dhe transparente nga ana e trupit që gëzon autonomi funksionale dhe operative, siç është p.sh. një trup i pavarur rregullues për medime. Trupat e pavarura, përgjegjësie për ndarjen e subvencioneve direkte duhet të publikojnë raporte vjetore për shfrytëzimin e fondeve publike për përkrahjen e aktorëve mediatic.

### 3. Rregullimi i pronësisë mediatike: pronësia, kontrolli dhe koncentrimi

3.1. Si pjesë e obligimit të tyre duhet të garantohet pluralizmi në sferat nën kompetencë të tyre, vendet anëtare inkurajohen që të zhvillojnë dhe zbatojnë një kornizë gjithpërfshirëse rregulluese që çon drejt një kujdesi të veçantë për pronësinë dhe kontrollin mediatic dhe që do të adaptohet sipas gjendjes aktuale të industrisë mediatike. Rregullativa që është relevante për mediumet duhet në tërësi të marrë parasysh ndikimin e online medimeve ndaj debatit publik, përfshirë edhe mënyrën se si do të sigurohet mbrojtja e krijuesve të përmbajtjeve mediatike që do të distribuohen përmes internet kanaleve për distribucion dhe të shfrytëzuesve përmes sjelljes së mundshme anti – konkurruese të online guardianëve që reflekton negativisht ndaj pluralizmit mediatic.

3.2. Mbikëqyrja dhe zbatimi i rregullativës relevante duhet të zbatohet nga ana e trupit të pavarur, të siguruar me resurse të mjaftueshme stabile financiare dhe njerëzore për të kryer me efikasitet detyrat e saja.

### *Pronësia dhe kontrolli*

3.3. Zbatimi i ligjit për mbrojtjen nga konkurrenca, përfshirë edhe masat për kontroll të masave që zbatohen ndaj medimeve, duhet të orientohen drejt sigurimit të një konkurrence efikase dhe ndaj asaj të pengohen aktorët e mundshëm për të fituar fuqi të caktuar tregtare në sektorin e plotë nacional mediatic ose të ndonjë tregu/sektori të caktuar mediatic në nivel nacional ose nënacional, deri në shkallën që fuqia e atillë tregtare do të reflektonte ndaj pluralizmit politik.



3.4. Rregullativa për pronësinë mediatike mund të përfshijë kufizime për pronësinë horizontale, vertikale ose ndër-mediatike, përfshirë edhe konstatimet e pragut të pronësisë në pajtim me Rekomandimin [CM/Rec\(2007\)2](#) nga Komiteti i minsitrave deri te vendet anëtare, në lidhje me pluralizmin mediatik dhe llojllojshmërinë e përmbajtjeve mediatike. Këto pragje mund të krijohen në bazë të disa kritereve, siç janë pjesmarrje në kapital, të drejtat e votuesit, tirazhi, të hyrat, ndikimi në shikueshmërinë/dëgjueshmërinë dhe shtrirja e publikut.

3.5. Vendet anëtare mund të vendosin kritere për përcaktimin e kontrollit ndaj medimeve përmes përcaktimit eksplicit të kontrollit direkt dhe të dobishëm. Kriteret relevante mund të përfshijnë fuqi pronësore, financiare ose votuese në kuadër të mediumit ose medimeve dhe përcaktimit të niveleve të ndryshme të fuqisë që çojnë deri te zbatimi i kontrollit ose ndikimit direkt ose indirekt në vendimmarrjen strategjike të mediumit ose medimeve, përfshirë edhe politikën e tyre redaktuese.

3.6. Duke pasur parasysh se detyrat kyçe demokratike të medimeve përfshijnë edhe përcjelljen e llogaridhënies së pushtetit dhe avancimit të transparencës, ndërmjetësimit të medimeve nga ana e partive politike ose individëve që janë të përfshirë aktivisht në politike, ose konkretisht nga dikush që është në pozitë të funksionarit, duhet të nënshtrohet kontrollit të forcuar, si p.sh ngë një sistem vetërregulluese, me qëllim të sigurimit të pavarësisë redaktuese dhe transparencës së pronësisë. Miratimi i vendimeve redaktuese duhet të mospërputhet me kryerjen e pushtetit politik. Mospërputhja e këtyre funksioneve duhet të përcaktohet në parim. Kriteret për mospërputhje dhe një sërë masash tjera adekuate për ballafaqim me konfliktin e interesave duhet që qartë të jenë të përcaktuara.

3.7. Kufizimet eventuale ndaj shkallës së pronësisë së jashtme mediatike duhet të zbatohen në mënyrë të drejtë dhe në tërësi duhet të inkorporojnë obligimet nga vendet anëtare që dalin nga e drejta ndërkombëtare dhe, në veçanti, obligimi pozitiv që të garantohet pluralizmi mediatik.

#### *Koncentrimi*

3.8. Vendet anëtare inkurajohen që të zhvillojnë dhe të zbatojnë metodologjitë adekuate për vlerësimin e koncentrimit mediatik, si në aspekt të ndikimit të medimeve të caktuara ashtu edhe në aspekt të ndikimit të mbledhur të një grupi të caktuar të mediumit në kufijtë sektorial. Përveç matjes së qasjes në burimet mediatike, ky vlerësim duhet të reflektojë edhe ndikimin e drejtë të gurpeve të veçanta përmes miratimit të qasjes së bazuar ndaj publikut dhe shfrytëzimit të kritereve adekuate të grupeve për matjen e shfrytëzimit të medimeve të caktuara dhe ndikimit të tyre ndaj formimit të mendimeve. Qasja e këtillë e bazuar në publik duhet të marrë parasysh reflektimin e medimeve dhe të rrjetit të internetit edhe jashtë saj (*offline* u *online*). Vlerësimi duhet të bëhet nga një institucion i pavarur ose trup tjetër i emëruar.

3.9. Më tutje, vendet anëtare inkurajohen që të sigurojnë procedurat për parandalimin e përputhjeve pse ndërmarrjeve të medimeve që mund të ndikojnë në mënyrë jo të mirë ndaj pluralizmit të pronësisë mediatike ose llojllojshmërisë së përmbajtjeve mediatike. Procedurat e këtilla duhet të përfshijnë kusht që pronarët e medimeve të informojnë trupin e pavarur rregullues kompetent për çfarëdo bashkimi të propozuar mediatik gjithmonë kur tejkalohe pragjet e pronësisë dhe kontrollit, të përcaktuara sipas legjislaturës.

3.10. Pushteti i pavarur kompetent rregullues ose ndonjë trup tjetër i emëruar duhet të autorizohen dhe të vlerësojnë ndikimin e pritur nga ndonjë koncentrim i propozuar dhe i rëndësishëm ndaj pluralizmit mediatik dhe të japin rekomandime ose të sjellin vendime, sipas nevojave, për atë nëse bashkimi ose ndërmarrja e propozuar duhet të miratohet, t'i nënshtrohet ose jo restriksioneve ose kushteve të caktuara, përfshirë edhe heqjen. Vendimet e trupit të pavarur duhet t'i nënshtrohen kontrollit gjyqësor.

#### 4. Transparenca e pronësisë mediatike, organizimi dhe financimi

4.1. Vendet anëtare duhet të promovojnë regjim të transparencës së pronësisë mediatike që do të sigurojë qasje për opinionin në të dhëna të sakta, të azhuruara për pronësinë direkte ndaj medimeve dhe posedimin e tyre në emër tjetër, si dhe interese tjera që ndikojnë ndaj vendimmarrjes strategjike të medimeve konkrete ose të linjës së tyre redaktuese. Këto informata nevojitet që të mund të zbatohen proceset rregulluese dhe vendimmarrëse të informimit, nga ana e trupave relevante për mediumet.

Gjithashtu, kjo i mundëson opinionit që të analizojë dhe vlerësojë informatat, idetë dhe mednimet që i përhapin mediumet.

4.2. Kërkesat eventuale për transparencë duhet të bazohen në kritere të qarta në aspekt të saj se me cilat medime kanë të bëjnë. Se vallë një medium i nënshtrohet kërkesës për zbulimin e pronarit ose j, mund të vart edhe nga natyra komerciale e mediumit, se sa është i gjërë përhapja në publik, nëse zbaton kontroll redaktues, cila është shpeshësia dhe rregullësia e publikimit os emetimit të tyre, etj. ose kominimi i këtyre dyjave. Legjislatura duhet ta përcaktojë edhe kornizën kohore në të cilën duhet të plotësohen obligimet për raportim.

4.3. Kërkesat për transparencë duhet të plotësohen në pajtim me të drejtën për privaci dhe mbrojtjen e të dhënave dhe duhet të kufizohen në individ që janë të involvuar direkt në pronësinë e ndonjë mediumi ose të strukturave të saja për mbikëqyrje redaktuese. Përveç kësaj, në rrethana të posaçme që duhet të theksohen në të drejtën nacionale, atje ku zbulimi i tërësishëm do ta ekspozonte pronarin në rrezi personal ose atje ku pronari është minoren ose i paaftë, vendet anëtare duhet të mundësojnë përjashtimin e kushtit për qasje në tërë ose një pjesë të informatave për pronësinë, veçanërisht për ndonjë rast konkret. Vendet anëtare duhet të mundësojnë që lirimet e këtilla të bazohen në vlerësimet e natyrës së veçantë të rrethanave.

#### *Kërkesat për transparencë*

4.4. Kërkesat për transparencë mediatike duhet të jenë konkrete dhe të përfshijë edhe kushtin që mediumet të cilat operojnë nën jurisdikcion të ndonjë vendi konkret anëtar, t'i zbardhin të dhënat për pronësinë tek opinionit, në ueb faqet e tyre ose në ndonjë publikim tjetër, dhe të dorëzojnë këto informata deri te trupi i pavarur rregullues ose ndonjë trup tjetër i obliguar për mbledhjen e këtyre informatave për sigurim të transparencës. Këtij trupi duhet t'i sigurohen resurse stabile financiare dhe personel që mundet me efikasitet të kryej detyrat e veta.

4.5. Vendet anëtare duhet të miratojnë dhe zbatojnë masat e legjislativës dhe masa tjera efektive të cilat qartë dhe në mënyrë precize i përcaktojnë obligimet për zbulimin e pronësisë ose transparencës së medimeve. Këto obligime mund të përfshijnë këto informata:

- emrin juridik të mediumit dhe informatat kontaktuese;
- emrin (ose emrat) dhe detajet për kontakt të pronarit direkt (pronarëve) me aksione që mu mundësojnë të ketë ndikim ndaj punës dhe vendimmarrjes strategjike të mediumit. Vendeve anëtare ju rekomandohet që të zbatojnë pragun prej 5% të aksioneve për obligimin e zbardhjes së pronësisë;
- emri (ose emrat) dhe detajet për kontaktimin e personave fizik me aksione në emër tjetër. Posedimi i aksioneve në emër tjetër që ka të bëjë me personave fizik që posedojnë ose kontrollojnë aksione në ndonjë medium ose në emër të të cilit janë aksionet, ju mundësojnë që indirekt të kontrollojnë ose të ndikojnë në punën dhe vendimmarrjen strategjike të mediumit;
- informatat për natyrën dhe vëllimin e aksioneve të poseduara ose të drejtave votuesve të personave të lartpërmendur juridik dhe/ose fizik në medime tjera, kompani reklamuese ose kompani në lidhje me medime, që mund të sjellë deri te ndikimi ndaj vendimmarrjes në ato kompani, ose pozicionet që të njëjtët ndoshta i kanë në partitë politike;
- emri (ose emrat) e personave me përgjegjësi të vërtetë redaktuese;
- ndryshime në strukturën pronësore dhe kontrollin e mediumit.

4.6. Kriteret e lartpërmendura për obligimet për zbardhjen e pronësisë ose për transparencë të medimeve që kanë të bëjnë me personat juridik dhe fizik me seli në kuadër të jurisdikcioneve tjera dhe të interesave të tyre relevante që janë nën jurisdikcione tjera.

4.7. Niveli i lartë i transparencës duhet të sigurohet edhe në aspekt të burimeve të financimit të medimeve, me qëllim që të merret një pasqyrë e përgjithshme për burimet e ndryshme të ndikimit potencial në pavarësinë redaktuese ose operative të medimeve dhe të mundësohet përcjellje efikase dhe kontroll i këtyre rreziqeve. Për këtë qëllim, vendet anëtare inkurajohen që të miratojnë dhe zbatojnë

legjislatore ose masa tjera efikade qe e rregullojne zbardhjen e informatave per burimet e financimit mediatik te marra nga mekanizmat e Shtetit (reklamimi, grantet dhe huatë). Përveç kesaj, vendet anëtare inkurajohen qe te nxisin mediumet per te zbardhur raportet kontraktuese me mediumet tjera ose kompanite reklamuese dhe partite politike qe mund te ndikojne ne pavarësinë redaktuese.

#### *Bazat e të dhënave dhe raportet për transparencën*

4.8. Legjislatuara e këtille duhet te mundësoje qe pushteti rregullues mediatik nacional dhe i pavarur ose trupat tjera te emëruara, te sigurojne qasje te lehte, te shpejte dhe efikase te opinionit deri te te dhënat per pronësinë mediatike dhe kontrollin brenda shtetit, përfshirë këtu edhe kufizimin e të dhënave per llojet e ndryshme te mediumeve (tregjet/sectorët) dhe nivelet rajonale dhe/ose lokale, varësisht nga relevanca. Këto të dhëna duhet qe rregullisht te azhurohen dhe te jene ne dispozicion te opinionit, falas dhe pa prolongime, ndërsa qasja e tyre duhet te jetë publike. Ne raste ideale, ato duhen te jene ne dispozicion dhe te mund te kërkohet ne to, p.sh, ne forme te bazës elektronike te të dhënave; përmbajtja e tyre duhet te jetë e qasshme ne formate te hapura dhe te mos ketë kufizime per përdorimin e tyre te sërishëm.

4.9. Vendet anëtare duhet ta inkurajojne trupin nacional mediatik rregullues ose trupe tjera te emëruara ose institucione (institucione akademike, organizata nga shoqëritë civile) te publikojne raporte te rregullta per pronësinë mediatike. Kërkesat per informim ne çdo vend anëtar duhet te përfshijne:

- përshkrimin e pronësisë mediatike dhe mekanizmave kontrolluese per mediumet nen jurisdikcion te saj (përfshirë edhe medimet, qe kanë shërbime ndaj vendeve tjera);
- përshkrimi i ndryshimeve ne pronësinë mediatike dhe mekanizmave kontrolluese te vendeve anëtare gjatë periudhës së raportimit;
- analiza e ndikimit te atyre ndryshimeve ndaj pluralizmit mediatik te vendet anëtare;

4.10. Publikimi i raporteve per pronësinë mediatike duhet te mbulohet me sqarime adekuate te të dhënave dhe metodologjite e shfrytëzuara per mbledhjen dhe organizimin e tyre, me qëllim qe t'u mundësohet pjestarëve te publikut gjatë interpretimit te të dhënave dhe kuptimit te rëndësisë së tyre.

#### *Koordinimi i regjimeve për transparencë*

4.11. Vendet anëtare inkurajohen qe te japin udhëzime te qarta, te azhuruara per lidhjet dhe implikimet e ndërsjella nga regjimet e ndryshme rregulluese si dhe per zbatimin e tyre te drejte dhe koherent.

4.12. Vendet anëtare duhet, qe gjithashtu ta lehtësojne bashkëpunimin dhe koordinimin ndërmjet agjencive përfshirë edhe shkëmbimin relevant te informatave per pronësinë mediatike qe e kanë organet e ndryshme nacionale (siç janë trupat rregulluese per mediumet, trupat per mbrojtjen e konkurrencës, trupat per mbrojtjen e të dhënave, regjistrave te kompanive dhe trupave per mbikëqyrje financiare). Ngjashëm me këtë, duhet te lehtësohet edhe shkëmbimi i informatave dhe praktikave më te mira me trupat ekuivalente te jurisdikcioneve tjera.

4.13. Informatat e azhuruara dhe te besueshme per çështjet ne lidhje me pronësinë mediatike paraqesin një resurs te rëndësishëm per qytetarët dhe per një spektër te gjërë te faktorëve, por mbledhja e informatave te këtilla ne një mënyrë paraqet edhe sfidë. Per këtë, shtetet anëtare inkurajohen qe te përkrahin aktivitetet per mbledhjen, azhurnimin dhe përhapjen e informatave rreth çështjeve nga sfera e pronësisë mediatike, siç janë aktivitetet relevante te Opservatorisë Evropiane audiovizuale, veçanërisht te bazës së saj te të dhënave MAVISE, nese këto aktivitete kontribojne per mirëkuptimin më te plotë te pronësisë së mediumeve ne Evropë.

#### 5. Arsimimi dhe edukimi mediatik

5.1. Vendet anëtare duhet të fusin dispozita ligjore që promovojnë arsimimin mediatic, ose që forcojnë ato ekzistuese, me qëllim që të mundësohet qasje e individëve, mirëkuptim, analizë kritike, vlerësim, shfrytëzimi dhe krijimi i përmbajtjeve përmes një sërë medimeve të trashëguara dhe digjitale (përfshirë edhe ato sociale). Qëllim tjetër i rëndësishëm i arsimimit mediatic është që t'u mundësohet individëve të dijnë dhe kuptojnë se si Internet platformat i mbledhin, ruajnë dhe shfrytëzojnë të dhënat e tyre personale.

5.2. Vendet anëtare duhet edhe të zhvillojnë një politik të koordinuar nacionale për arsimimin mediatic dhe të sigurojnë operacionalizimin e saj dhe zbatimin përmes planeve aksionare disavjeçare si dhe përmes sigurimit të resurseve adekuate për këto qëllime. Strategji kyçe mund të jetë edhe përkrahja për krijimin e rrjetit të koordinuar nacional për arsimimin mediatic që do të përfshijë spektër të gjërë të faktorëve, ose zhvillim të mëtejshëm të rrjetit të atillë aty ku nuk ekziston një gjë e tillë. Praktikrat pozitive të zhvilluara në kuadër të rrjeteve nacionale, duhet që në mënyrë aktive të shkëmbehen dhe promovohen në forumet relevante ndërkombëtare.

5.3. Në ekosistemin multimediatik, arsimimi mediatic është më rëndësi esenciale për njerëzit e të gjitha moshave dhe sferave në jetë. Kështu, masat për promovimin e arsimimit mediatic duhet të ndihmojnë në zhvillimin e mësimin të arsimimit mediatic në programet mësimore shkollore në të gjitha nivelet si dhe në një pjesë të cikleve të mësimin jetësor, përfshirë edhe përmes sigurimit të trajnimit adekuat për mësimdhënësit dhe resurse adekuate për institucionet arsimore për zhvillimin e programeve mësimore dhe skemave për mesim të orientuara drejt projekteve.

5.4. Vendet anëtare duhet t'i inkurajojnë të gjitha mediumet për të promovuar arsimimin mediatic përmes politikave, strategjive dhe aktiviteteve, pa u përz'ër në pavarësinë e tyre redaktuese. Sipas natyrës së qëllimeve, mandateve dhe metodave të tyre punuese, shërbimet publike mediatike dhe mediumet e bashkësive mund të luajnë rol udhëheqës në promovimin e arsimimit mediatic. Vendet anëtare gjithashtu duhet të promovojnë arsimimin mediatic përmes skemave për përkrahjen e medimeve, duke marrë parasysh rolet konkrete të shërbimeve publike mediatike dhe medimeve të bashkësive.

5.5. Vendet anëtare duhet të sigurojnë kushte për organet nacionale rregulluese dhe/ose trupat tjerë që të kanë shtrirjen dhe resurset e nevojshme për promovimin e arsimimit mediatic në mënyrë që përputhet me mandatet e tyre dhe t'i inkurajojë të njëjtit që të bëjnë atë.

5.6. Vendet anëtare inkurajohen që të kushtojnë vëmendje të veçantë ndaj pluralizmit mediatic dhe transparencës së pronësisë mediatike në programet e tyre të koordinuara nacionale për arsimimin mediatic, me qëllim që t'u ndihmojnë qytetarëve që të kenë vlerësime të informuar dhe kritik të informatave dhe ideve që propagohen përmes medimeve. Për këtë qëllim vendet anëtare ftohen që në strategjitë e tyre për sigurimin e transparencës në sektorin mediatic, të përfshijnë përmbajtje arsimore që do t'u mundësojnë individëve të shfrytëzojnë informatat për pronësinë, organizimin dhe financimin e medimeve me qëllim që të kuptojnë më mirë ndikimet e ndryshme për prodhimin, mbledhjen, organizimin dhe përhapjen e përmbajtjeve mediatike.

---

[1]Gjatë miratimit të këtij Rekomandimi, përfaqësuesi i përhershëm i Federatës Ruse potencoi se në pajtim me Nenin 10.2s nga Rregullorja e takimeve të zëvendësministrave, ai e ruan të drejtën e qeverisë së tij për të kufizuar shtrirjen për zbatimin e Rekomandimit për Federatën Ruse ndaj medimeve, siç edhe është e theksuar në legjislaturën e Federatës Ruse.